

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “BUILD CORE” shpk

Në Tiranë, sot më datë 23.01.2025, ne të poshtëshënuarit:

Mario Alliaj, i datëlindjes 06.11.1987, lindur ne Vlorë dhe banues në Athinë, Greqi, identifikuar me dokument identifikimi, pashaporte, me numër personal, I71106063B.

Amarildo Kamberaj, i datëlindjes 15.12.1996, lindur ne Fier dhe banues në Athinë, Greqi, identifikuar me dokument identifikimi, pashaporte, me numër personal, J61215011V.

Me cilësinë e “ortakeve themelues”deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “**BUILD CORE**” shpk.

Neni 1 Emri

Shoqëria do të ketë emrin“**BUILD CORE**” shpk .

Neni 2 Forma juridike

“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” më poshtë e quajtur “Shoqëria”

Neni 3 Personaliteti juridik

Shoqëritë e fiton personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.

Neni 4 Selia

Shoqëria “**BUILD CORE**” shpk e ka seline në adresë: Patos Fshat, Fier, Ndërtesa me numër pasurie 196/59-ND, me Kod Unik 2891011061, Zona Kadastrale 2891 dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 5 Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarisë per shoqërine “**BUILD CORE**” shpk është: Shitje me shumicë të materialeve të ndërtimit; shërbime të fushës së ndërtimit si restaurim objekteve, rikonstruksion objekteve, përmirësimi i kushteve të brendshme të objekteve; Tregtim të makinave dhe mjeteve të lehta motorike; tregtimi e paisjeve elektrike; menaxhim të pronave;

agjensi e marketingut të pronave; Agjensi imobiliare; Shitje e tregtim të materialeve, hidraulike, pllaka, qeramikë, hidrosanitare, hekur, çelik, bakër, alumin, murale, mermer, etj.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota te cilat zotërohet si më poshtë:

Mario Alliaj, i datëlindjes 06.11.1987, lindur ne Vlorë dhe banues në Athinë, Greqi, identifikuar me dokument identifikimi, pashaporte, me numër personal, I71106063B, zotëron një kuotë ose **50 % të shoqërisë**.

Amarildo Kamberaj, i datëlindjes 15.12.1996, lindur ne Fier dhe banues në Athinë, Greqi, identifikuar me dokument identifikimi, pashaporte, me numër personal, J61215011V, zotëron një **kuotë ose 50 % të shoqërisë**.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë, pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë **“BUILD CORE” shpk** është: Besjan Asqeri, i datëlindjes 13.04.1990, lindur ne Gjirokaster dhe banues në Tirane, identifikuar me dokument identifikimi, pashaporte, me numër personal, J00413083F.

Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar. Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqërisë qe eshte data 23.01.2025.

Afati i emerimit te administratorit eshte deri me 23.01.2030.

Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne këtë akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”* i ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipëri dhe çfare do ligji tjetër specifik të Republikën e Shqipërisë.

Neni 11 Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortakët themelues të shoqërisë


tregtare "BUILD CORE" shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKET THEMELUES

Mario Alliaj

Mario Alliaj 

Amarildo Kamberaj

AMARILDO KAMBERAJ 

Tiranë, më datë 23.01.2025